



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_, Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 46 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe me aktin nr. 5623 prot., datë 19.11.2024, referuar ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Kandidat për magjistrat konsiderohet personi, i cili ka rezultuar fitues referuar rezultateve të provimit të pranimit, të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës, dhe është kualifikuar për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar, me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pas përfundimit të procesit të verifikimit të pasurisë dhe figurës, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Pas këtij momenti, kandidati për magjistrat, i shpallur fitues nënshkruan marrëveshjen e regjistrimit me Shkollën e Magjistraturës, e cila parashikon të drejtat dhe përgjegjësitë e kandidatit përgjatë Programit të Formimit Fillestar.

Sa më sipër, në kushtet kur, në këtë rast kemi të bëjmë me një marrëdhënie juridike mes Shkollës së Magjistraturës dhe kandidatit, lutemi të referoheni në Aneksin nr. 7, të Rregullores së Shkollës së Magjistraturës, miratuar me vendimin nr. 1, datë 31.1.2017, i ndryshuar, e cila përcakton në mënyrë të detajuar të gjitha të drejtat dhe detyrimet midis palëve.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!